



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, pikës 9 të nenit 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05nr.350/03 – 88767/21 dt. 19.05.2021 të kërkuarit / subjektit juridik "Premtimi OP" me emër tregtar N.T.P."Premtimi" nga Prishtina, Lagjja e Spitalit, p.n. me numër identifikimi 810502288 dhe përfaqësues Petrit Gashi nga Prishtina, për ndryshim - plotësimin e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02– 235747/19 dt.14.07.2020 të Drejtorisë së Urbanizimit,Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullte administrative dhe duke vepruar sipas kërkesës së palës, me datë 20.05.2021, merr këtë:

## V E N D I M

NDRYSHIM - PLOTËSIM I VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE  
05NR.350/02 – 235747/19 DT.14.07.2020

**I. Ndryshohet-plotësohet** Vendimi i kushteve ndërtimore 05 nr.350/02 – 235747/19 dt.14.07.2020, të caktuara nga kjo drejtori, në emër të kërkuarëve / pronarëve, Eshref dhe Almir Ajeti, Shpëtim Çelaj, Halil, Hyrishah, Faruk, Bajram, Bujar, Fadil, Behar, Burim, Hetem dhe Bali Gashi, Besa Veliu, Zenel dhe Ilmi Sopjani dhe Besnik Lecit, nga Prishtina dhe Investitorit "Premtimi OP" me emër tregtar N.T.P."Premtimi" nga Prishtina, Lagjja e Spitalit, p.n. me numër identifikimi 810502288 dhe përfaqësues Petrit Gashi, sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 235747/19 dt.25.09.2019 dhe kërkesës për pranimin e palës në procedurë, 05nr.350/02 – 75253/20/1 dt.09.07.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "1" & "2" në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "b\_09", Nën tërësia "B-2", Tërësia hapësinore "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" në Prishtinë, konkretisht në kuadër dhe parcelave kadastrale, nr. 2665-1, 2666-9, 2668-3 & 2668-4 ZK Prishtinë, pjesës së parcelës kadastrale, nr.2669-0 ZK Prishtinë, me S=215m<sup>2</sup>, me pronar / posedues P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, trajtuar përmes këmbimit me parcelën kadastrale nr.996-0 ZK Matiçan, të pronarit Besnik Leci nga Prishtina, sipas projekt propozimit konceptual & Planit të situacionit – "zgjdhjes urbane".

- Ndryshimi- plotësimi i vendimit të kushteve ndërtimore ka të bëjë me plotësimin e paragrafit III. / I caktohen kushtet ndërtimore / dhe paragrafit VIII. / Këmbimi/, dhe atë:

Në paragrafin III. / I caktohen kushtet ndërtimore / shtohet edhe pjesa e tekstit: "me këmbim edhe me parcelën kadastrale nr.997-4 dhe 997-5 ZK Matiçan me pronar Besnik Leci nga Prishtina me S=310 + 125 + 87=522m<sup>2</sup>";

Në paragrafin VIII. / Këmbimi/, ndryshohet nga:

"Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.2669-0 ZK Prishtinë, me S=215m<sup>2</sup> dhe me pronar / posedues P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, do të realizohet me pjesën e parcelës kadastrale nr.996-0 ZK Matiçan me pronar Besnik Leci nga Prishtina, e destinuar në hapësirë publike – "rrugë" bazuar në kriteret e planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", kushtet ndërtimore dhe rregullativën ligjore në fuqi", dhe bëhet,

"Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.2669-0 ZK Prishtinë, me S=215m<sup>2</sup> dhe me pronar / posedues P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, do të realizohet me pjesën e parcelës kadastrale nr.996-0 ZK Matiçan me pronar Besnik Leci nga Prishtina dhe pjesë të parcelës kadastrale nr.997-4 dhe 997-5

ligjore në fuqi”

II. Ky vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 235747/19 dt.14.07.2020, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

## A r s y e t i m

Kërkuesi / subjekti juridik, "Premtimi OP" me emër tregtar N.T.P."Premtimi" nga Prishtina, Lagjja e Spitalit,p.n. me numër identifikimi 810502288 dhe përfaqësues Petrit Gashi, me kërkesën nr.350/03 – 8876/21, ka kërkuar nga kjo drejtori ndryshim-plotësimin e Vendimit 05 nr.350/02 – 235747/19 dt.14.07.2020 të Drejtorisë së Urbanizimit mbi caktimin e kushteve ndërtimore, në emër të kërkuesve / pronarëve, Eshref dhe Almir Ajeti, Shpëtim Çelaj, Halil, Hyrishah, Faruk, Bajram, Bujar, Fadil, Behar, Burim, Hetem dhe Bali Gashi, Besa Veliu, Zenel dhe Ilmi Sopjani dhe Besnik Lecit, nga Prishtina dhe Investitorit "Premtimi OP" me emër tregtar N.T.P."Premtimi" nga Prishtina, Lagjja e Spitalit, p.n. me numër identifikimi 810502288 dhe përfaqësues Petrit Gashi, sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 235747/19 dt.25.09.2019 dhe kërkesës për pranimin e palës në procedurë, 05nr.350/02 – 75253/20/1 dt.09.07.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti "1" & "2", në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të këtij vendimi.

Drejtorja e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesës së lartë cekur konsultimit të dosjeve të lëndëve paraprake të zhvilluar në këtë drejtori nga arkivi i drejtorisë, si dhe konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe pas pranimit të shkresës, konstatoi se:

Kjo drejtori bazuar me Vendimin 05 nr.350/02 – 235747/19 dt.14.07.2020 ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, ku në paragrafin VIII. të dispozitivit, ka paraparë, citojmë, *"Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.2669-0 ZK Prishtinë, me S=215m<sup>2</sup> dhe me pronar / posedues P.SH. Rrugët - KK Prishtinë, do të realizohet me pjesën e parcelës kadastrale nr.996-0 ZK Matiçan me pronar Besnik Leci nga Prishtina, e destinuar në hapësirë publike – "rrugë" bazuar në kriteret e planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", kushtet ndërtimore dhe rregullativën ligjore në fuqi"*.

Pas zhvillimit të procedurave të parapara ligjore, në Drejtorinë e Pronës së Komunës së Prishtinës , Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe të Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Vlerësimit, kjo e fundit në vlerësimin e pronave të parapara për këmbim, është konstatuar se pronat bazuar në vlerësim, nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për këmbim, andaj edhe është paraqitur nevoja për parcela shtesë, të cilën kërkuesi, N.T.P."Premtimi" nga Prishtina, Lagjja e Spitalit,p.n. me numër identifikimi 810502288 dhe përfaqësues Petrit Gashi, pas pranimit të informatës nga Drejtorja e Pronës e Komunës së Prishtinës, me kërkesën 05nr.350/02 – 8876/21 dt.19.05.2021, ka kërkuar nga kjo drejtori ndryshim – plotësim të vendimit të kushteve ndërtimore duke prezantuar edhe parcelat kadastrale nr.997-4 dhe 997-5 ZK Matiçan, me pronar Besnik Leci nga Prishtina, të cilat janë të destinuara në hapësirë publike – "rrugë" dhe janë të dedikuara për këmbim (pjesët e tyre) ;

Drejtorja e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesës së lartë cekur, dokumentacionin e prezantuar dhe konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konstatoi se bazuar në vlerësimin e Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Vlerësimit është paraqitur nevoja për korigjimin(shtimin e parcelave) në paragrafin VIII. dhe në paragrafin III. të dispozitivit të kushteve ndërtimore, andaj edhe vendosi që përmes këtij vendimi vendos që ta realizoj ndryshim - plotësimin e vendimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

I dërgohet: Kërkuesit, kësaj Drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe vendoset në dosjen e lëndës, 05nr.350/02 – 235747/19 dt.25.09.2019 dhe 05nr.350/02 – 75253/20 dt.26.05.2020.


I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastrë, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Sektorit për Planifikim dhe Sektorit për Mjedis.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 350/02 – 235747/19 DT.20.05.2021**

Zyrtari:  
Ergyn Hajredini,



U.D. Udheheqëse e Sektorit:  
Mimoza Berisha Prestreshi,



Drejtori:  
Adnan Olluri.



